



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22.07.2024

Nr: 104

Ora: 18:09

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË LIGHT STUDIO AGENCY, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE PËR
VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR Kryetar TË Bashkisë Himarë TË DATËS 4 GUSHT
2024

Sot në datën 22.07.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Light Studio Agency, me adresë në Rruga Medar Shtylla, Kompleksi Tirhino, Kulla D, Ap.6/4;

OBJEKTI: Kërkohe akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve te pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 22.07.2024
Ora: 18:09

Nr: 104



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

V Ë R E J:

Light Studio Agency i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 1 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 18.07.2024.

Light Studio Agency, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 1 vëzhguesve të Light Studio Agency për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 22.07.2024 Nr: 104
Ora: 18:09



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve te Miratuar te Light Studio Agency

	Emri	Mbiemri	Mandati	Seriali	Zona e vëzhgimit
1.	Malton	Dibra	Media	000032	Ne te gjithe vendin

Data: 22.07.2024
Ora: 18:09

Nr: 104



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024